

VENDIM
Nr.928, datë 28.12.2011

PËR PËRDORIMIN E TË ARDHURAVE TË PARKUT KOMBËTAR TË BUTRINTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të ardhurat e krijuara nga Parku Kombëtar i Butrintit përdoren në masën 90% nga ky institucion dhe klasifikohen si të ardhura jashtë limitit.

2. Kriteret dhe procedurat e përdorimit të të ardhurave të përcaktohen në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Financave, Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Financave dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 2012 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha